



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2023 (KLASA 9-të)

RAPORT PUBLIK

MBI

ARRITJET E NXËNËSVE

Përmbledhja

<u>Hyrje</u>	3
<u>Tabela e shkurtimeve</u>	3
<u>1. Metodologjia</u>	4
<u>2. Statistika përmbledhëse për PKAB 2023</u>	5
<u>3. Statistika Krahësuese PKAB 2021-2023</u>	6
<u>I. Lënda: Gjuhë Shqipe</u>	7
<u>1.1 Arritjet e Nxënësve</u>	7
<u>1.2 Arritjet në nivel kombëtar</u>	10
<u>1.3 Arritjet sipas gjinisë</u>	11
<u>1.4 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	12
<u>1.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	12
<u>1.6 Qëndrueshmëria e arritjeve</u>	13
<u>1.7 Qëndrueshmëria e arritjeve sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	15
<u>1.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem</u>	17
<u>1.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës shqipe</u>	21
<u>II. Lënda: Matematikë</u>	23
<u>2.1 Arritjet e Nxënësve</u>	23
<u>2.2 Arritjet në nivel kombëtar</u>	25
<u>2.3 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	26
<u>2.4 Arritjet sipas gjinisë</u>	26
<u>2.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	27
<u>2.6 Qëndrueshmëria e arritjeve</u>	27
<u>2.7 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	30
<u>2.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem</u>	31
<u>2.9 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Matematikës</u>	34
<u>III. Lënda: Gjuhë e Huaj</u>	35
<u>3.1 Arritjet e Nxënësve</u>	37
<u>3.2 Në nivel kombëtar</u>	41
<u>3.3 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat</u>	41
<u>3.4 Arritjet sipas gjinisë</u>	41
<u>3.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit</u>	41
<u>3.6 Të dhëna të tjera për rezultatet e provimit të Gjuhës së huaj</u>	42
<u>IV. Renditja e shkollave në bazë të mesatares së arritjeve në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë</u>	49

Hyrje

Matja e arritjeve të nxënësve në përfundim të një niveli arsimor shërben jo vetëm për të pasqyruar funksionimin e sistemit arsimor dhe kontekstin e politikave arsimore aktuale, por edhe për të ndërtuar politika të reja arsimore. Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.

Raporti publik i Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2023 shërben për t'u siguruar politikëbërësve, përdoruesve dhe publikut informacion për rezultatet e nxënësve dhe për faktorët që ndikojnë në to. Ai synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve të klasës së nëntë.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel ZVAP-je, por njëkohësisht edhe krahasimin mes ZVAP-ve, duke iu referuar edhe arritjeve në nivel kombëtar.

Tabela e shkurtimeve

MAS – Ministria e Arsimit dhe Sportit

QSHA – Qendra e Shërbimeve Arsimore

ZVAP – Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare

PKAB – Provimi Kombëtar i Arsimit Bazë

NV – Nota Mesatare Vjetore

NP – Nota Mesatare e Provimit

NVk – Nota Mesatare Vjetore në nivel Kombëtar

NPk – Nota Mesatare e Provimit në nivel Kombëtar

1. Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga QSHA gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2023 (këtu e në vijim PKAB). Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Gjuhë e huaj.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave janë:

- ZVAP (së cilës i përket shkolla që ka ndjekur nxënësi);
- shkolla e ndjekur;
- gjinia e nxënësit;
- lloji i shkollës (publike/jopublike);
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet);
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor 2022-2023;
- pikët e fituara në provime nga çdo nxënës;
- notat në provimet e arsimit bazë;
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor (për lëndët e provimeve të arsimit bazë).

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve në **PKAB** 2023 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar;
- në nivel ZVAP-je;
- sipas urbanizimit (fshat/qytet);
- sipas gjinisë (vajza/djem);
- sipas llojit të shkollës (publike/jopublike).

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve të nxënësve të vitit shkollor 2022-2023, të cilët morën pjesë në **PKAB** 2023, në sesionin e parë. Informacioni statistikor i përfshirë nga përpunimi është paraqitur në formë tabelare dhe/ose grafike.

Raporti përmban treguesit e mëposhtëm statistikorë:

- mesatarja e pikëve të fituara në testim;
- nota mesatare vjetore (NV);
- nota mesatare e provimit (NP);
- shmangia standarde - (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*);
- nota mesatare vjetore në nivel kombëtar (NV_k);
- nota mesatare e provimit në nivel kombëtar (NP_k);
- kalueshmëria në provimin kombëtar të Arsimit Bazë;
- diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar (NV – NV_k);
- diferenca e Notës së provimit me Notën e provimit në nivel kombëtar (NP – NP_k).

2. Statistika përmbledhëse për PKAB 2023

Tabela 1.1: Të dhëna statistikore përmbledhëse për provimet e PKAB 2023.

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në PKAB		
		Total	Publik	Jopublik
1	Gjuhë shqipe (Total)	28205	25590	2615
	Qytet	16840	14334	2506
	Fshat	11365	11256	109
	Vajza	13480	12209	1271
	Djem	14725	13381	1344
2	Matematikë (Total)	28212	25608	2604
	Qytet	16862	14346	2516
	Fshat	11350	11262	88
	Vajza	13489	12219	1270
	Djem	14723	13389	1334
3	Gjuhë e Huaj (Total)	28552	25923	2629
	Qytet	17001	14481	2520
	Fshat	11551	11442	109
	Vajza	13647	13647	1270
	Djem	14905	13546	1359

Tabela 1.1, paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për PKAB 2023, për sesionin e parë. Në tabelën 1.1 është paraqitur numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të Arsimit Bazë 2023, të klasifikuar sipas kategorive: publik/jopublik, fshat/qytet, vajza/djem, arritjet e të cilëve janë përdorur për përgatitjen e këtij raporti.

3. Statistika Krahasuese PKAB 2021-2023

Tabela 1.2: Të dhëna statistikore përmblledhëse për dy vitet e fundit.

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në PKAB
		Total	Publik	Jopublik	(në %)	
2023						
1	Gjuhë shqipe	28205	25590	2615	99.7%	8.29
2	Matematikë	28212	25608	2604	99.79%	7.43
3	Gjuhë e Huaj	28552	25923	2629	99.98%	8.73
Të gjitha lëndët		84969	77121	7848	99.82%	8.15
2022						
1	Gjuhë shqipe	28957	26601	2356	99.84 %	8.19
2	Matematikë	28986	26626	2360	99.9 %	7.45
3	Gjuhë e Huaj	28859	26506	2353	99.92 %	8.47
Të gjitha lëndët		86802	79733	7069	99.88 %	8.03
2021						
1	Gjuhë shqipe	30391	28090	2301	99.49 %	7.73
2	Matematikë	30369	28065	2304	99.3 %	7.00
3	Gjuhë e Huaj	30211	27912	2299	99.89 %	8.62
Të gjitha lëndët		90971	84067	6904	99.56 %	7.78

Tabela 1.2, paraqet të dhëna statistikore përmblledhëse për PKAB 2021 - 2023.

Nga krahasimi i të dhënave të **PKAB** të dy viteve të fundit, për të gjitha lëndët rezulton se:

- kalueshmëria e nxënësve në **PKAB 2023**, është **0.06%** më e ulët në krahasim me vitin **2022**, por **0.26%** më e lartë së viti **2021**.
- nota mesatare, krahasuar me vitin **2022** është **0.12** njësi note më e lartë, ndërsa krahasuar me vitin **2021** është **0.37** njësi note më e lartë.

1.1 Arritjet e Nxënësve

Në provimin e lëndës së Gjuhës shqipe morën pjesë **28205** nxënës. **Tabela 1.3** paraqet pikët mesatare të fituara nga nxënësit e çdo ZVAP-je në **PKAB**, të lëndës Gjuhë Shqipe.


Tabela 1.3: Arritjet mesatare për çdo ZVAP.

Nr.	ZVAP	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
	Në nivel kombëtar	35.50	9.81	8.29	1.35	7.46	1.72
1	Belsh	34.46	9.88	8.13	1.40	7.04	1.58
2	Berat	37.89	8.97	8.60	1.26	7.68	1.73
3	Bulqizë	26.72	11.10	7.10	1.62	6.65	1.59
4	Cërrik	30.64	10.26	7.67	1.40	7.05	1.73
5	Devoll	35.16	9.21	8.26	1.25	7.61	1.74
6	Dibër	28.98	9.00	7.39	1.27	6.94	1.66
7	Divjakë	36.85	8.64	8.48	1.19	7.23	1.75
8	Durrës	36.55	9.43	8.43	1.31	7.42	1.73
9	Elbasan	37.21	10.03	8.50	1.37	7.49	1.70
10	Fier	35.63	9.84	8.32	1.34	7.57	1.72
11	Finiq-Dropull	40.34	7.73	8.82	1.11	7.73	1.65
12	Gjirokastër-Libohovë	37.84	8.86	8.61	1.21	7.62	1.73
13	Gramsh	34.74	9.55	8.18	1.38	7.64	1.76
14	Has	25.09	10.70	6.90	1.48	7.56	1.66
15	Kamëz	33.00	9.59	7.90	1.34	6.92	1.64
16	Kavajë	38.06	9.73	8.62	1.32	7.56	1.75
17	Klos	35.62	9.12	8.26	1.33	7.43	1.58
18	Kolonje	35.39	9.82	8.33	1.37	7.54	1.84
19	Korçë-Pustec	35.83	9.37	8.33	1.32	7.38	1.79
20	Krujë	34.29	9.41	8.05	1.25	7.15	1.71
21	Kuçovë	32.25	10.04	7.80	1.44	7.15	1.59
22	Kukës	33.40	9.14	7.96	1.28	7.39	1.65
23	Kurbin	35.69	8.95	8.34	1.27	7.64	1.78
24	Lezhë	34.20	9.46	8.16	1.28	7.18	1.73
25	Librazhd	34.93	9.07	8.21	1.23	7.34	1.69
26	Lushnje	37.96	9.26	8.64	1.27	7.68	1.77
27	Malësi e Madhe	32.65	9.51	7.88	1.28	7.05	1.69
28	Maliq	33.25	9.20	7.98	1.29	6.93	1.60
29	Mallakastër	35.80	9.12	8.34	1.29	7.69	1.69
30	Mat	33.59	9.84	8.06	1.36	7.21	1.65

31	Mirditë	35.67	9.72	8.28	1.35	7.37	1.69
32	Patos	34.45	8.73	8.17	1.19	7.16	1.63
33	Peqin	34.64	11.62	8.11	1.61	7.70	1.77
34	Përmet-Këlcyrë	34.95	9.26	8.18	1.31	7.19	1.63
35	Përrenjas	36.63	8.06	8.43	1.14	7.48	1.63
36	Pogradec	32.88	11.17	8.05	1.36	7.53	1.66
37	Poliçan	38.44	8.43	8.65	1.21	7.35	1.79
38	Pukë	34.08	9.68	8.07	1.37	7.75	1.53
39	Roskovec	31.36	9.99	7.60	1.46	7.29	1.63
40	Rrogozhinë	35.54	8.81	8.32	1.25	7.18	1.69
41	Sarandë-Konispol - Delvinë	35.60	9.01	8.29	1.23	7.41	1.77
42	Selenicë	38.45	7.94	8.68	1.13	7.21	1.62
43	Shijak	33.35	9.61	8.02	1.32	7.40	1.64
44	Shkodër	37.10	9.19	8.51	1.26	7.40	1.73
45	Skrapar	26.48	10.04	7.10	1.35	6.91	1.49
46	Tepelenë-Memaliaj	30.72	10.35	7.66	1.44	7.42	1.55
47	Tiranë	37.14	9.49	8.52	1.31	7.76	1.68
48	Tropojë	37.05	9.59	8.51	1.27	8.08	1.55
49	Dimal	30.13	10.65	7.53	1.49	7.16	1.72
50	Vau Dejës	32.15	9.08	7.87	1.21	6.84	1.62
51	Vlorë-Himarë	36.98	9.32	8.49	1.29	7.54	1.73
52	Vorë	33.46	9.10	8.01	1.23	6.96	1.59

Të dhënat e kësaj tablele janë paraqitur në **Grafikun 1.1**. Grafiku tregon mesataret e pikëve të secilës ZVAP, duke i krahasuar ato me mesataren e pikëve në nivel kombëtar që është **35.50 pikë/nxënës**.

Grafiku 1.1: Arritjet mesatare për çdo ZVAP.



1.2 Arritjet në nivel kombëtar

- **Mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e Gjuhës shqipe është **35.50 pikë**, me shmangie mesatare **9.81**.
- **Nota mesatare e provimit** është **8.29**, me shmangie mesatare **1.35**.
- **Nota mesatare vjetore** është **7.46**, me shmangie mesatare **1.72**.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të provimit të arsimit bazë, referuar po nivelit kombëtar, rezulton se nota mesatare e provimit kombëtar është **0.83** njësi notë më e lartë se nota mesatare vjetore.

Gjithashtu, vëmë re se pothuajse në të gjitha ZVAP-të, arritjet mesatare të nxënësve në provim janë më të larta, sesa arritjet mesatare të tyre gjatë vitit. ZVAP Selenicë, dallohet për diferencë më të lartë midis notës vjetore dhe asaj së provimit (nota mesatare vjetore **7.21**, nota mesatare e provimit **8.68**).

Arritjet mesatare të nxënësve në provim janë më të ulta krahasuar me arritjet mesatare vjetore, në:

- në ZVAP Has, nota mesatare vjetore është **0.06** njësi notë më e lartë se nota mesatare e provimit kombëtar;

Tabela 1.4: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive.

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	F	39.09	8.40	8.77	1.17	8.15	1.53
	M	32.22	9.87	7.84	1.36	6.82	1.63
	Grand Total	35.50	9.81	8.29	1.35	7.46	1.72
Qytet	Vajza	40.51	7.85	8.97	1.10	8.31	1.52
	Djem	34.37	9.59	8.14	1.33	7.07	1.69
	Total	37.31	9.32	8.53	1.29	7.66	1.72
Fshat	Vajza	36.98	8.74	8.48	1.21	7.90	1.52
	Djem	29.03	9.40	7.41	1.29	6.46	1.46
	Total	32.83	9.92	7.92	1.36	7.15	1.66
Publik (në nivel kombëtar)	Vajza	38.64	8.48	8.71	1.18	8.08	1.54
	Djem	31.54	9.74	7.75	1.34	6.70	1.59
	Total	34.93	9.83	8.21	1.36	7.36	1.71
Qytet	Vajza	39.99	8.02	8.90	1.13	8.22	1.53
	Djem	33.55	9.54	8.02	1.32	6.90	1.65
	Total	36.62	9.41	8.44	1.31	7.53	1.73
Fshat	Vajza	36.93	8.74	8.48	1.21	7.89	1.52
	Djem	28.96	9.38	7.40	1.29	6.44	1.46
	Total	32.77	9.91	7.92	1.36	7.14	1.66
Jopublik	Vajza	43.42	6.00	9.38	0.86	8.83	1.32

(në nivel kombëtar)	Djem	39.00	8.43	8.78	1.17	8.06	1.51
	Total	41.15	7.67	9.07	1.07	8.43	1.47
Qytet	Vajza	43.46	6.00	9.38	0.86	8.83	1.33
	Djem	39.15	8.38	8.79	1.16	8.08	1.52
	Total	41.25	7.63	9.08	1.07	8.44	1.48
Fshat	Vajza	42.48	5.86	9.24	0.87	8.84	1.04
	Djem	35.66	8.80	8.39	1.17	7.64	1.27
	Total	38.79	8.29	8.78	1.13	8.19	1.31

Tabela 1.4 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe. Arritjet e nxënësve janë dhënë **në nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë vajza/djem**, si edhe sipas **sistemit publik/jopublik të edukimit**.

1.3 Arritjet sipas gjinisë

Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, tregon se:

- arritjet mesatare për vajzat janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve.
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth **6.87 pikë** më e lartë, krahasuar me mesataren e pikëve të fituara nga djemtë.

Nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve-vajza, në provimet kombëtare, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se vajzat kanë një qëndrueshmëri më të mirë të rezultateve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore të tyre (nota mesatare në **PKAB** është **8.77**, kundrejt **8.15** që është nota mesatare vjetore).

Nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve-djem, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se djemtë kanë marrë një vlerësim më të lartë në rezultate në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore të tyre (nota mesatare në **PKAB** është **7.84**, kundrejt **6.82** që është nota mesatare vjetore).

1.4 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse do të analizojmë arritjet e nxënësve, në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat, rezultojnë se:

- ekzistojnë diferenca mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat.
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezultojnë të jetë rreth **4.48** pikë më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit.

Ekzistenca e diferencës prej **4.48 pikësh** në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën e notës mesatare të **PKAB**-së që ekziston mes dy kategorive, vlera e së cilës është me **0.61** njësi notë.

Në nivel kombëtar, diferencat e arritjeve midis kategorive Qytet dhe Fshat janë përkatësisht: për vajzat **3.53** pikë, ndërsa për djemtë **5.34** pikë.

Për të tre treguesit statistikorë të tabelës 1.4, shihet se arritjet e vajzave në qytet janë më të larta kundrejt arritjeve të vajzave të fshatit.

Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, vajzat e qytetit kanë një notë mesatare vjetore me një vlerë prej **0.41** më të lartë se vajzat e fshatit. Kjo diferencë arrin deri në **0.49** njësi note, nëse i referohemi arritjeve në provimin kombëtar të arsimit bazë.

Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, djemtë e qytetit kanë një notë mesatare vjetore me një vlerë prej **0.61** më të lartë se djemtë e fshatit. Kjo diferencë arrin deri në **0.73** njësi note, nëse i referohemi arritjeve në provimin kombëtar të arsimit bazë.

1.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit

Diferenca të mëdha ekzistojnë edhe mes dy sistemeve arsimore (publik/jopublik). Nga të dhënat e tabelës 1.4, rezultojnë se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin jopublik të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik.

Kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të provimit dhe atë vjetore.

Të njëjtat dallime ekzistojnë, edhe nëse krahasojmë arritjet e nxënësve vajza/djem në sistemin publik me arritjet e nxënësve vajza/djem në sistemin jopublik, si edhe për kategoritë fshat/qytet në sistemin publik, kundrejt kategorive fshat/qytet në sistemin jopublik.

1.6 Qëndrueshmëria e arritjeve

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore, duke krahasuar notën mesatare vjetore me notën mesatare të provimit, shihet se qëndrueshmëria e arritjeve në sistemin publik është **(0.85)** dhe për atë jopublik **(0.64)**.

Paqëndrueshmëria më e madhe vihet re në kategorinë - djem si në sistemin publik **(1.05)**, ashtu edhe në atë jopublik **(0.72)**. Vajzat kanë arritje më të qëndrueshme krahasuar me djemtë. Për sistemin publik, për kategorinë - vajza, diferenca midis notës mesatare të PKAB me notën mesatare vjetore është vetëm **(0.63)** dhe në atë jopublik vetëm **(0.55)**.

Tabela 1.5 dhe **Grafiku 1.2**, paraqesin shpërndarjen (në përqindje) të notave të provimit të arsimit bazë për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 1.5: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë.

Sistemi i edukimit	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	0.312%	2.59%	7.56%	16.5%	22.1%	23.6%	18.09%
Jopublik	0.004%	0.06%	0.23%	0.5%	1.4%	3.0%	4.04%
Në nivel kombëtar	0.316%	2.64%	7.79%	17.03%	23.52%	26.57%	22.13%

Grafiku 1.2: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë.





Tabela 1.6: Shpërndarja e notave vjetore.

Sistemi i edukimit	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	16.90%	16.81%	14.83%	15.17%	13.32%	13.70%
Jopublik	0.35%	0.82%	1.28%	1.86%	1.90%	3.05%
Në nivel kombëtar	17.26%	17.62%	16.11%	17.04%	15.22%	16.75%

Tabela 1.6 dhe Grafiku 1.3, paraqesin shpërndarjen e notave vjetore për lëndën e Gjuhës shqipe.

Grafiku 1.3: Shpërndarja e notave vjetore.



Në nivel kombëtar, në provimin e arsimit bazë, lënda Gjuhë Shqipe:

- kalueshmëria është 99.7%
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 9 me 26.57%**.
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** në nivel kombëtar për PKAB 2023 është e lartë (**22.13%**).

1.7 Qëndrueshmëria e arritjeve sipas urbanizimit qytet/fshat

Në **tabelën 1.7**, paraqiten përqindjet për notat e provimit PKAB dhe ato vjetore sipas kategorisë qytet dhe fshat.

- të dhënat tregojnë se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Arsimit Bazë, 22.13% e totalit të nxënësve, prej të cilëve 5.33% janë nxënës që i përkasin kategorisë - fshat, dhe 16.81% i përkasin kategorisë – qytet;
- rezultatet e arritura në provimin e arsimit bazë, si dhe ato vjetore të nxënësve të qytetit janë përgjithësisht më të larta, kundrejt nxënësve të fshatit;
- në notat e provimit të arsimit bazë, nxënësit e qytetit dhe të fshatit e kanë përqindjen më të lartë në notën 9, ndërsa për notën 10, përqindja e nxënësve të qytetit është trefish më e lartë, krahasuar me nxënësit e fshatit;
- nëse shohim arritjet e nxënësve për notat 4-7, përqindja e nxënësve të fshatit është më e lartë, krahasuar me ata të qytetit, ndërsa për notat 8-10 ndodh e kundërta. Në këtë interval note (8-10), përqindja e nxënësve të qytetit është më e lartë;
- në notat vjetore, nxënësit e qytetit e kanë përqindjen më të lartë në notën 10 me **12.19%** ndërsa nxënësit e fshatit në notën 5 dhe 6 me **8.40%**

Tabela 1.7: Arritjet në PKAB sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	0.12%	1.09%	3.24%	8.33%	13.16%	16.96%	16.81%
Fshat	0.20%	1.56%	4.55%	8.70%	10.36%	9.61%	5.33%
Në nivel kombëtar	0.32%	2.65%	7.79%	17.03%	23.52%	26.57%	22.13%

Grafiku 1.4: Arritjet në *PKAB-së sipas urbanizimit*.





Tabela 1.8: Arritjet vjetore sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	8.86%	9.23%	9.18%	10.47%	9.79%	12.19%
Fshat	8.40%	8.40%	6.93%	6.56%	5.44%	4.56%
Në nivel kombëtar	17.26%	17.62%	16.11%	17.04%	15.22%	16.75%

Në **tabelën 1.8**, paraqiten përqindjet për arritjet vjetore në lëndën e Gjuhës Shqipe kategorisë qytet dhe fshat.

Grafiku 1.5: Arritjet vjetore sipas urbanizimit.



1.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem

Nga të dhënat e paraqitura më poshtë (në formë tabelare dhe grafike) për arritjet në provimin kombëtar, si dhe ato për arritjet gjatë vitit shkollor, mund të veçojmë:


Për provimin e arsimit bazë:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë;
- vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 10 me **15.58%** për arritjet në provimin e arsimit bazë. Ndërkohë që djemtë kanë notën 8 me **13.52%**
- vajzat kanë përqindjen më të madhe në notat 9 dhe 10, ndërsa djemtë në notat 7 dhe 8.

Tabela 1.9: Arritjet e PKAB-së sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	0.04%	0.57%	1.56%	4.55%	10.01%	15.48%	15.58%
Djem	0.28%	2.07%	6.23%	12.48%	13.52%	11.09%	6.55%
Në nivel kombëtar	0.32%	2.64%	7.79%	17.03%	23.52%	26.57%	22.13%

Grafiku 1.6: Arritjet në **PKAB** sipas gjinisë.



Për arritjet gjatë vitit shkollor:

- vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 10 me **12.10%**, për notën vjetore, ndërsa djemtë kanë notën 5 me **14.47%**
- vajzat kanë përqindje më të lartë në notat 9 dhe 10, respektivisht me **9.95%** dhe **12.10%**
- djemtë kanë përqindje më të lartë në notat 5 dhe 6, respektivisht me **14.47%** dhe **12.01%**.

Tabela 1.10: Arritjet vjetore sipas gjinisë.

Gjinia	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	2.79%	5.62%	7.52%	9.81%	9.95%	12.10%
Djem	14.47%	12.01%	8.59%	7.23%	5.27%	4.65%
Në nivel kombëtar	17.26%	17.63%	16.11%	17.04%	15.22%	16.75%




Tabela 1.11: paraqet informacion mbi nivelin e paqëndrueshmërisë së rezultateve vjetore, të krahasuara me rezultatet e fituara në provimin e arsimit bazë për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 1.11: lexohet si më poshtë:

- nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve të vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 10 në lëndën e Gjuhës shqipe përbëjnë **16.75%**, ndërkohë që, nxënësit të cilët e kanë ruajtur vlerësimin me notën 10 në provimin e gjuhës shqipe përbëjnë **12.08%** të totalit të nxënësve;
- nëse rezultatet e nxënësve do të ishin të qëndrueshme, atëherë në PKAB duhet të rezultonin **16.75%** nota 10 në nivel kombëtar. Ndërkohë, ka ndodhur që nxënës të vlerësuar me notën 10 në procesin mësimor vjetor, në provimin kombëtar janë vlerësuar me notën 5 (**0.00%**) notën 6 (**0.00%**), notën 7 (**0.07%**), notën 8 (**0.64%**), notën 9 (**3.95%**) dhe notën 10 (**12.08%**);
- këto shifra tregojnë se nxënësit e vlerësuar me notën 10 gjatë vitit shkollor, në provimin kombëtar janë vlerësuar edhe me notën 7, 8 apo 9. Pra, vlerësimi i tyre është ulur me 2-3 nota.

Të dhënat e **Tabelës 1.11** tregojnë se një përqindje e caktuar e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 5 e 6, në provimin kombëtar kanë arritur të marrin vlerësimin 7, 8 e 9.


Nga **17.62%** e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 6, vetëm **2.18%** e tyre kanë mbajtur po atë notë në provimin kombëtar.

Dukuria e paqëndrueshmërisë së njohurive lidhet me shkallën e fiktivitetit në shkollë, ndërsa dukuria e vlerësimit me 2-3 nota më lartë në provimin kombëtar tregon për nivel të ulët të monitorimit të mjediseve të provimit.

Tabela 1.11: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së notës.

Notat vjetore në %		Notat e PKAB -së në përqindje						
		Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
5	17.26%	0.22%	1.84%	4.61%	6.80%	3.11%	0.64%	0.05%
6	17.62%	0.06%	0.56%	2.18%	5.53%	6.55%	2.48%	0.26%
7	16.11%	0.03%	0.18%	0.73%	2.98%	6.25%	5.04%	0.90%
8	17.04%	0.00%	0.05%	0.22%	1.29%	4.73%	7.51%	3.24%
9	15.22%	0.00%	0.01%	0.05%	0.35%	2.24%	6.95%	5.61%
10	16.75%	0.01%	0.00%	0.00%	0.07%	0.64%	3.95%	12.08%
Gjithsej	100%	0.32%	2.64%	7.79%	17.03%	23.52%	26.57%	22.13%

Grafiku 1.8: Shpërndarja e pikëve për provimin e arsimit bazë, Gjuhë shqipe.



Grafiku 1.8, paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë, në lëndën “Gjuhë shqipe” 2023. Grafiku tregon se kemi një shpërndarje normale të arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë. Maksimumi është arritur në 45 pikë/nxënës nga 1316 nxënës.

Në përfundim mund të themi:

Rezultatet e arritjeve të nxënësve në testin e **Gjuhës shqipe, PKAB 2023**, (duke u nisur nga të dhënat e mësipërme) klasifikohen si më poshtë

- **Dobët** (vlerësuar me notën **4** në **PKAB 2023**). Sipas statistikave rezulton se **0.32 %** e nxënësve nuk e kanë kapërcyer nivelin minimal të arritjeve.
- **Mjaftueshëm** (përfshihen nxënësit që kanë nivelin e parë dhe që kanë fituar notën **5** dhe **6**). Nga tabela rezulton se **2.64%** e nxënësve kanë marrë notën **5** dhe **7.79%** e nxënësve kanë marrë notën **6**. Nga një analizë e këtyre të dhënave, vërejmë se ky grup nxënësish kanë siguruar arritjet e mëposhtme:
 - përdorin drejt njohuritë për të kuptuar në mënyrë **të përgjithshme** tekstin.
 - dallojnë faktin nga opinionin.
 - gjejnë kuptime të fjalëve të thjeshta.
 - identifikojnë detajet më të dukshme.
 - zbulojnë temën kryesore të fragmenteve.
 - dallojnë numrit njëjës dhe shumës.
 - përmbahen brenda temës së esesë.
 - shtjellojnë **shumë pak** idenë e një paragrafi.

- zbulojnë raporte të thjeshta shkak-pasojë.
 - shkruajnë saktë fjalë të thjeshta.
 - dallojnë lidhëzat dhe klasat më kryesore të fjalëve (emër, mbiemër).
 - perifrazojnë në mënyrë **sipërfaqësore** informacionet kryesore të tekstit.
- **Mirë** (përfshihen nxënësit që kanë fituar nivelin e dytë të arritjeve, nivel që përkon me notat **7-8**), ku **17.03%** e nxënësve kanë fituar notën **7** dhe **23.52%** kanë fituar notën **8**. Nxënësit e këtij grupimi, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë aftësitë e mëposhtme:
- bëjnë shpjegime të pjesshme, duke u bazuar në tekstet.
 - dallojnë idenë kryesore të tekstit.
 - argumentojnë në mënyrë të përgjithshme mendimet e tyre.
 - analizojnë fjali të thjeshta që realizojnë përshkrime të personazheve.
 - dallojnë marrësin e mesazhit në skemën e komunikimit.
 - zbulojnë gjendjen shpirtërore të personazhit.
 - dallojnë përemrat, parafjalët dhe trajtat e shkurtra.
 - zbulojnë shkallët e mbiemrave.
 - shpjegojnë llojet e kallëzuesve të thjeshtë e të përbërë.
 - shpjegojnë funksionet e fjalëve në fjali.
 - organizojnë fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin dhe llojin e tekstit.
 - përdorin **relativisht** drejt shenjat e pikësimit.
- **Shumë mirë** (përfshin nivelin e tretë të arritjeve, që përkon me notat **9** dhe **10**). Nga tabela rezulton se **26.57%** e nxënësve kanë marrë notën **9** dhe **22.13%** kanë marrë notën **10**, të cilët, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë, veç të tjerash, edhe aftësitë e mëposhtme:
- vlerësojnë në thellësi informacionet në tekst.
 - bëjnë lidhje mes tekstit dhe ideve të tjera jashtë tekstit në një situatë të re.
 - ndërtojnë lloje të ndryshme fjalish.
 - nxjerrin përfundime mbi çështje të rëndësishme në tekst.
 - përfytyrojnë situata që rrjedhin nga logjika e tekstit.
 - përdorin strategji personale për të bindur lexuesin.
 - formojnë fjali të llojeve të ndryshme.
 - përshtatin në kohë e mënyrë gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë.
 - përdorin drejt në të gjitha rastet shenjat e pikësimit.
 - interpretojnë informacionet e marra nga teksti me burime të tjera të informacionit.
 - kanë stil origjinal në punën me shkrim.
 - formojnë fjali të llojeve të ndryshme, duke përdorur drejt rregullat e koherencës dhe kohezionit.
 - analizojnë në thellësi personazhet e fragmenteve.

II. Lënda: Matematikë

2.1 Arritjet e Nxënësve

Tabela 2.1: Arritjet mesatare për çdo ZVAP

Nr	ZVAP	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar		29.01	10.53	7.43	1.47	7.06	1.75
1	Belsh	31.39	9.47	7.76	1.32	6.84	1.64
2	Berat	30.69	9.43	7.67	1.31	7.21	1.75
3	Bulqizë	21.47	9.32	6.40	1.36	6.35	1.56
4	Cërrik	26.81	10.69	7.12	1.50	6.59	1.70
5	Devoll	30.19	9.32	7.57	1.32	7.16	1.84
6	Dibër	25.17	8.86	6.89	1.24	6.50	1.61
7	Divjakë	31.75	8.79	7.85	1.20	6.87	1.72
8	Durrës	30.22	10.14	7.60	1.39	7.00	1.76
9	Elbasan	32.05	10.67	7.82	1.44	7.11	1.76
10	Fier	29.59	10.39	7.51	1.44	7.54	1.88
11	Finiq-Dropull	32.39	8.12	7.89	1.03	7.32	1.35
12	Gjirokastër-Libohovë	26.24	10.60	7.06	1.52	7.22	1.76
13	Gramsh	30.64	10.17	7.68	1.45	7.19	1.71
14	Has	19.06	7.48	6.05	1.15	7.31	1.82
15	Kamzë	24.25	8.63	6.78	1.24	6.50	1.57
16	Kavajë	33.89	11.21	8.10	1.52	7.27	1.85
17	Klos	26.58	9.05	7.13	1.31	7.05	1.74
18	Kolonje	29.78	10.77	7.64	1.52	7.10	1.84
19	Korçë-Pustec	29.42	10.67	7.49	1.46	7.09	1.85
20	Krujë	29.44	9.98	7.39	1.35	6.98	1.67
21	Kuçovë	24.89	9.48	6.91	1.34	6.64	1.60
22	Kukës	30.39	9.45	7.58	1.31	7.11	1.64
23	Kurbin	29.02	10.37	7.44	1.45	7.40	1.71
24	Lezhë	24.06	9.55	6.78	1.36	6.73	1.64
25	Librazhd	28.50	9.05	7.37	1.27	7.02	1.70
26	Lushnje	35.54	10.33	8.32	1.39	7.33	1.84
27	Malësi e Madhe	25.63	8.18	7.01	1.13	6.38	1.53
28	Maliq	26.25	9.12	7.08	1.28	6.63	1.63
29	Mallakastër	30.34	10.12	7.60	1.43	7.15	1.87
30	Mat	26.40	10.99	7.05	1.55	6.68	1.72
31	Mirditë	24.97	10.03	6.88	1.44	6.88	1.79
32	Patos	25.78	8.68	7.01	1.22	6.62	1.59
33	Peqin	32.67	11.92	7.93	1.65	7.50	1.74

34	Përmet-Këlcyrë	29.21	9.81	7.47	1.37	7.06	1.70
35	Përrenjas	29.65	9.32	7.49	1.33	7.06	1.60
36	Pogradec	29.69	10.37	7.48	1.46	7.24	1.74
37	Poličan	27.78	8.59	7.29	1.24	7.31	1.75
38	Pukë	27.31	10.25	7.22	1.44	7.27	1.60
39	Roskovec	26.66	9.80	7.10	1.39	6.70	1.53
40	Rrogozhinë	31.49	9.92	7.78	1.44	7.10	1.75
41	Sarandë- Konispol - Delvinë	28.05	9.82	7.30	1.36	7.05	1.69
42	Selenicë	28.61	8.08	7.38	1.05	6.82	1.54
43	Shijak	26.13	9.40	6.99	1.40	6.98	1.66
44	Shkodër	29.43	10.11	7.48	1.40	6.82	1.72
45	Skrapar	22.64	7.24	6.59	0.99	7.18	1.68
46	Tepelenë-Memaliaj	34.16	9.49	8.07	1.28	7.38	1.74
47	Tiranë	29.82	10.93	7.55	1.53	7.27	1.77
48	Tropojë	34.77	8.65	8.23	1.15	7.71	1.57
49	Dimal	22.32	9.98	6.45	1.46	6.52	1.69
50	Vau Dejës	23.83	9.53	6.70	1.35	6.36	1.61
51	Vlorë-Himarë	30.26	10.81	7.59	1.49	7.22	1.75
52	Vorë	25.40	9.07	6.92	1.28	6.61	1.60

Tabela 2.1 paraqet pikët mesatare të fituara nga nxënësit e çdo ZVAP, në provimin kombëtar të Matematikës.

Nisur nga **Tabela 2.1**, duket vihet re se:

- Pikët mesatare në nivel kombëtar janë **29.01** pikë/nxënës
- ZVAP Lushnjë kryeson me pikët mesatare më të larta (**35.54**), pra me **6.53** pikë/nxënës më shumë se ai kombëtar.

Kjo ZVAP ka gjithashtu edhe rritje të notës mesatare të **PKAB**-së nga ajo vjetore, me **0.99 njësi note**.

- Ndërsa ZVAP Has, ka rezultatet më të ulta në pikë mesatare për nxënës, vetëm **19.06** duke rezultuar me **9.95 pikë/nxënës** më pak se treguesi kombëtar.
Kjo ZVAP ka gjithashtu edhe një rënie të cilësisë së notës vjetor e 1.26 njësi note.
- Nota mesatare më e lartë është **8.32** dhe **8.23**, e arritur përkatësisht në ZVAP-të, Lushnjë dhe Tropojë, të cilat janë me pikët mesatare përkatësisht **35.54** dhe **34.77**.

2.2 Arritjet në nivel kombëtar

Në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, morën pjesë **28212** nxënës.

Tabela 2.2: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive.

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	Vajza	31.33	10.54	7.75	1.46	7.57	1.69
	Djem	26.89	10.06	7.14	1.41	6.59	1.68
	Total	29.01	10.53	7.43	1.47	7.06	1.75
Qytet	Vajza	33.10	10.60	7.99	1.47	7.73	1.73
	Djem	28.94	10.52	7.42	1.47	6.84	1.76
	Total	30.93	10.76	7.69	1.49	7.26	1.81
Fshat	Vajza	28.70	9.87	7.39	1.37	7.33	1.60
	Djem	23.86	8.48	6.72	1.21	6.23	1.47
	Total	26.17	9.49	7.04	1.33	6.76	1.63
Publik (në nivel kombëtar)	Vajza	30.75	10.45	7.67	1.45	7.49	1.68
	Djem	26.17	9.73	7.04	1.37	6.47	1.62
	Total	28.36	10.34	7.34	1.44	6.95	1.73
Qytet	Vajza	32.39	10.60	7.89	1.47	7.61	1.73
	Djem	28.03	10.25	7.29	1.43	6.65	1.72
	Total	30.11	10.65	7.58	1.48	7.11	1.79
Fshat	Vajza	28.65	9.87	7.38	1.37	7.33	1.60
	Djem	23.80	8.45	6.72	1.20	6.22	1.47
	Total	26.12	9.47	7.03	1.33	6.75	1.63
Jopublik (në nivel kombëtar)	Vajza	36.93	9.73	8.51	1.35	8.36	1.58
	Djem	34.12	10.48	8.12	1.45	7.86	1.67
	Total	35.49	10.22	8.31	1.41	8.11	1.64
Qytet	Vajza	37.00	9.75	8.52	1.35	8.38	1.58
	Djem	34.25	10.49	8.14	1.45	7.89	1.67
	Total	35.59	10.23	8.32	1.41	8.13	1.64
Fshat	Vajza	34.86	9.15	8.24	1.28	7.86	1.44
	Djem	30.52	9.69	7.63	1.31	7.02	1.45
	Total	32.59	9.63	7.92	1.32	7.42	1.50

Në tabelën 2.2, paraqiten arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë vajza/djem**, dhe sipas **sistemit publik/jopublik** të edukimit.

Në nivel kombëtar vihet re se:

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e arsimit bazë në lëndën e Matematikës është **29.01 pikë**, me shmangie mesatare **10.53**;

- **nota mesatare e provimit të arsimit bazë** është **7.43**, me shmangie mesatare **1.47**;
- **nota mesatare vjetore** është **7.06**, me shmangie mesatare **1.75**.

Në nivel kombëtar, nga krahasimi i vlerave të notës mesatare në provimin e arsimit bazë me notën mesatare vjetore, rezulton se ndryshueshmëria është me një rritje prej **0.37** njësi note.

Rezultatet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve.

2.3 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në tabelën 2.2, rezulton se **mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit** dhe, konkretisht, për çdo kategori kemi:

- në nivel kombëtar, arritjet e nxënësve sipas kategorive të urbanizimit fshat/qytet, tregojnë se kemi diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit rezulton të jetë **4.76 pikë** më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit.
- për sistemin publik, mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është **3.99 pikë** më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit.
- për sistemin jopublik, mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është **3 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.

2.4 Arritjet sipas gjinisë

Të dhënat e tabelës 2.2 tregojnë se:

- në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, arritjet mesatare të vajzave janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve.
- arritjet mesatare të vajzave janë **2.32 pikë** mbi mesataren e pikëve mesatare në nivel kombëtar.
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat, në nivel kombëtar, është **31.33 pikë/nxënës**, ose **4.44 pikë/nxënës** më e lartë, se mesatarja e pikëve të fituara nga djemtë.
- arritjet e vajzave në provimin e arsimit bazë janë **0.18 njësi note** më të lartë, kundrejt arritjeve vjetore (në nivel kombëtar: **7.43** nota mesatare e **PKAB-së**; **7.57** nota mesatare vjetore dhe **7.75** nota e **PKAB-së**).
- për djemtë arritjet në provimin e PKAB janë **0.55 njësi note** më të larta kundrejt rezultateve vjetore të tyre (në nivel kombëtar: **7.43** nota mesatare **PKAB**; **6.59** nota mesatare vjetore dhe **7.14** nota e **PKAB-së**).

2.5 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit

Nga analiza e të dhënave rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin jopublik të edukimit janë më të larta se arritjet e nxënësve të sistemit publik, kjo si për mesataren e pikëve mesatare për nxënës të fituara në provim, po ashtu edhe për notën mesatare **PKAB** dhe atë vjetore.
- diferenca e pikëve mesatare mes sistemit jopublik dhe atij publik në nivel kombëtar është **7.13** pikë/nxënës.
- në sistemin jopublik, ashtu si dhe në atë publik, arritjet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të tyre. Për sistemin jopublik kjo diferencë është **0.2** njësi note, ndërsa për atë publik, diferenca midis arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e arsimit bazë janë **0.39** njësi note.

2.6 Qëndrueshmëria e arritjeve

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë, kundrejt arritjeve vjetore, për lëndën e Matematikës, shihet se:


- për sistemin publik, arritjet e nxënësve të fshatit janë më të qëndrueshme, krahasuar me arritjet e nxënësve të qytetit, ndërsa për sistemin jopublik ndodh e kundërta.

Tabela 2.3: Shpërndarja e notave për lëndën e Matematikës.

Sistemi i edukimit	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	0.20%	8.07%	20.06%	24.31%	17.58%	11.46%	9.10%
Jopublik	0.00%	0.25%	0.90%	1.57%	1.92%	2.16%	2.42%
Në nivel kombëtar	0.20%	8.32%	20.95%	25.88%	19.50%	13.62%	11.52%

Tabelat 2.3 dhe 2.4 paraqesin shpërndarjen (në përqindje) të notave të **PKAB** dhe notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Grafiku 2.1: Shpërndarja e notave PKAB-së, për lëndën e Matematikës.




Në provimin e arsimit bazë, në nivel kombëtar:

- kalueshmëria është **99.79%**;
- nota mbizotëruese është **nota 7** me **25.88%**;
- përqendrimi më i madh është në notat **6, 7, 8** të cilat së bashku përbëjnë **66.33%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** shkon në **11.52%**;

Tabela 2.4: Shpërndarja e notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Sistemi i edukimit	Nota e vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Publik	25.52%	18.54%	13.31%	12.48%	9.94%	10.99%
Jopublik	0.77%	1.13%	1.39%	1.68%	1.61%	2.66%
Në nivel kombëtar	26.28%	19.67%	14.70%	14.16%	11.54%	13.65%


Grafiku 2.2: Shpërndarja e notave vjetore për lëndën e Matematikës.



Për notat vjetore, në nivel kombëtar vihet re se:

- nota mbizotëruese është nota **5 me 26.28%**;
- përqendrimi më i madh është në notat **5,6 dhe 7**, të cilat së bashku përbëjnë **60.65%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **9** shkon në **11.54%**
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** shkon në **13.65%**

Grafiku 2.3: Arritjet në provimin e Matematikës



Grafiku 2.3 paraqet një krahasimin midis arritjeve në provimin e arsimit bazë dhe atyre vjetore.

2.7 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Tabela 2.5: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	0.06%	3.93%	10.42%	14.01%	12.26%	9.70%	9.39%
Fshat	0.15%	4.39%	10.53%	11.87%	7.25%	3.92%	2.13%
Në nivel kombëtar	0.21%	8.32%	20.95%	25.88%	19.50%	13.62%	11.52%

Tabela 2.5 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas urbanizimit.

Sipas të dhënave të tabelës 2.5, vihet re:

- Përqindja e nxënësve që kanë marrë notën **10** në provimin e arsimit bazë, është **11.52%** e numrit të përgjithshëm të nxënësve, prej të cilëve vetëm **2.13%** janë nxënës që i përkasin kategorisë-fshat, ndërsa pjesa tjetër prej **9.39%** i përkasin kategorisë-qytet.
- Shihet se, për kategorinë- qytet, nota me përqindjen më të lartë është nota **7** me **14.01%**, gjithashtu edhe për kategorinë- fshat është nota **7**, me **11.87%** të nxënësve.

Tabela 2.6: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës, sipas urbanizimit.

Urbanizimi	Nota vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Qytet	13.98%	10.97%	8.38%	8.64%	7.38%	10.43%
Fshat	12.31%	8.70%	6.32%	5.52%	4.17%	3.22%
Në nivel kombëtar	26.28%	19.67%	14.70%	14.16%	11.54%	13.65%

- për notat vjetore, sipas urbanizimit qytet/fshat vërejmë se **13.65%** e nxënësve ka marrë notën **10**;
- gjithashtu vihet re se notën **10** e kanë marrë **10.43%** e nxënësve të qytetit dhe **3.22%** e nxënësve të fshatit.
- nota me përqindjen më të lartë në nivel kombëtar është nota 5, të cilën e kanë marrë **26.28%** e nxënësve.

2.8 Arritjet sipas gjinisë vajza/djem

Tabela 2.7: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e PKAB në Matematikë						
	Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	0.09%	2.88%	7.16%	11.53%	10.65%	8.15%	7.35%
Djem	0.12%	5.44%	13.79%	14.35%	8.85%	5.47%	4.17%
Në nivel kombëtar	0.21%	8.32%	20.95%	25.88%	19.50%	13.62%	11.52%

Tabela 2.7 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas gjinisë.

Tabela 2.8: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës sipas gjinisë.

Gjinia	Nota e vjetore në Matematikë					
	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Vajza	6.57%	9.00%	7.80%	8.44%	7.06%	8.95%
Djem	19.72%	10.67%	6.90%	5.72%	4.48%	4.70%
Në nivel kombëtar	26.28%	19.67%	14.70%	14.16%	11.54%	13.65%


Për lëndën e Matematikës, rezulton se:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë;
- përqindja e nxënësve që kanë marrë notën **10** në provimin e arsimit bazë, është **11.52%** e totalit të nxënësve, prej të cilëve **7.35%** janë vajza dhe vetëm **4.17%** janë djem;
- përqindja e mbetësve në provimin e arsimit bazë, për kategorinë “djem” (**0.12%**), është më e madhe, krahasuar me kategorinë “vajza” (**0.09%**)
- në rezultatet e provimit të arsimit bazë, për vajzat nota me përqindjen më të lartë është nota 7 (me **11.53%**), ndërsa për djemtë është nota 7 (me **14.35%**);


- në rezultatet vjetore, vihet re se për djemtë nota 5 ka përqindjen më të madhe (**19.72%**) ndërsa për vajzat nota me përqindjen më të madhe është **6** (me **9.00%**).
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** gjatë procesit mësimor vjetor është **13.65%**, prej të cilëve **8.95%** janë vajza dhe **4.70%** djem. Nëse e krahasojmë me notën vjetore të **PKAB-së**, ajo është më e ulët . Në PKAB, nota **10** është me **11.52%**, pra më e ulët se **13.65%** që kanë marrë notën **10** në notat vjetore. Kjo ka ardhur si rezultat i fiktivitetit në vlerësim.

Më poshtë paraqiten grafikisht të dhënat e tabelave 2.4 dhe 2.5.


Grafiku 2.4: Arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë, sipas gjinisë.



Grafiku 2.5: Arritjet vjetore në Matematikë, sipas gjinisë.



Grafiku 2.6: Shpërndarja e pikëve për Matematikën.



Grafiku 2.6 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë, në lëndën e Matematikës. Grafiku paraqet një shpërndarje relativisht jonormale, të zhvendosur ndaj boshtit vertikal.

Tabela 2.9: Krahasoni i shpërndarjes së notave në PKAB me shpërndarjen e tyre vjetore.

Notat vjetore në %		Notat e PKAB në %						
		Nota 4	Nota 5	Nota 6	Nota 7	Nota 8	Nota 9	Nota 10
Nota 5	26.28%	0.13%	4.93%	10.72%	7.85%	2.26%	0.34%	0.06%
Nota 6	19.67%	0.03%	2.08%	5.45%	7.13%	3.80%	1.01%	0.17%
Nota 7	14.70%	0.01%	0.78%	2.59%	4.98%	4.05%	1.82%	0.46%
Nota 8	14.16%	0.02%	0.37%	1.40%	3.49%	4.51%	3.22%	1.15%
Nota 9	11.54%	0.00%	0.13%	0.59%	1.80%	3.03%	3.62%	2.36%
Nota 10	13.65%	0.01%	0.03%	0.21%	0.63%	1.86%	3.60%	7.32%
Gjithsej	100%	0.21%	8.32%	20.95%	25.88%	19.50%	13.62%	11.52%

Shihet se përqendrimi më i madh (**66.33%**) është në intervalin e notave **6, 7 dhe 8**.

Po të bëjmë një interpretim përmes klasifikimit të rezultateve të arritjes, nisur nga grafiku 2.9 arrijmë në konkluzionet si më poshtë:

- *Dobët* (përfshihen nxënësit që janë vlerësuar me notën **4** në Testin e **PKAB**-së).
- Nga grafiku Rezulton se **0.21%** e nxënësve janë vlerësuar në këtë nivel. Kjo do të thotë që ky grup nxënësish nuk e kanë kapërcyer nivelin minimal të arritjeve.
- *Mjaftueshëm*: Po të specifikojmë (sipas kompetencave të lëndës), vërejmë se ky grup nxënësish kanë fituar arritje të mjaftueshme në masën **8.32%**
- *Mirë* (përfshihen nxënësit që kanë nivelin e dytë të arritjeve). Nga grafiku rezulton se:
 - përqendrimi më i madh është në notat **6, 7 dhe 8** të cilat së bashku përbëjnë **66.33%**;
 - në këtë grup nxënësish, nota mbizotëruese është nota **7 me 25.88%**.
- *Shumë mirë* (përfshin nivelin e tretë të arritjeve, që përkon me notat **9 dhe 10**).

Nga Grafiku rezulton se përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** shkon në **11.52%**.

Ky grup nxënësish ka përmbushur nivelin më të lartë të kompetencave lëndore në testim.

❖ **Kompetencat lëndore që përmbush testi i PKAB-së, lënda Matematikë:**

Kompetenca: **Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik:**

Nxënës-i/ja:

- mbledh, zbret, shumëzon dhe pjesëtojnë numrat e plotë, dhjetorë dhe thyesorë.
- përdor zbatime të veprimeve me bashkësi;
- zgjidh ekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore;
- zgjidh ekuacione të thjeshta eksponenciale duke zbatuar veti të fuqive.

Kompetenca: **Zgjidhja e situatës problemore.**

Nxënës-i/ja:

- zgjidh një trekëndësh kënddrejtë përmes Teoremës së Pitagorës dhe vetisë së këndeve plotësuese.
- zgjidh situata problemore me perimetrin dhe syprinën e rrethit.
- zgjidh sisteme të thjeshta të ekuacioneve të fuqisë së parë me dy ndryshore duke eliminuar njërin prej ndryshoreve.
- formon ekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore.
- zhvillon vargun aritmetik kur jepen tri kufizat e para të tij, dhe gjen formulën e vargut.
- plotëson të dhëna të munguara në një tabelë të dhënash mbi një shpërndarje të caktuar.

Kompetenca: **Arsyetimi dhe vërtetimi matematik.**

Nxënës-i/ja:

- përdor teoremën e Pitagorës për të zgjidhur situata problemore në trekëndëshat kënddrejtë.
- zgjidh situata problemore duke përfshirë përpjesëtimin e drejtë, apo të zhdrejtë, mes madhësive fizike, siç janë rruga me kohën, ose shpejtësia me kohën e lëvizjes.

Kompetenca: **Modelimi matematik.**

© QSHA 2023

Nxënës-i/ja:

- zgjidh situata problemore duke përdorur përqindjen, në kontekste nga jeta familjare, kryen veprime financiare.
- interpreton përkufizimin klasik të probabilitetit të një ngjarjeje dhe e gjen atë.
- interpreton diagramën e Venit dhe e vizaton atë.
- interpreton matematikisht lidhjet mes të dhënave të situatës problemore të modeluar nga jeta reale.

3.1 Arritjet e Nxënësve

Në provimin e arsimit bazë, lënda Gjuhë e Huaj, nxënësit kanë dhënë provim njërën nga gjuhët e huaja: Anglisht, Frëngjisht, Italisht ose Gjermanisht, bazuar në kurrikulën shkollore, si dhe në rregulloren e zhvillimit të **PKAB**-së.

Në **tabelën 3.1** paraqiten arritjet mesatare të nxënësve në provimin e arsimit bazë, lënda Gjuhë e Huaj. **Grafiku 3.1** paraqet informacion mbi arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës së huaj në nivel kombëtar.

Tabela 3.2: Arritjet mesatare për çdo ZVAP në Gjuhë të huaj.

	ZVAP	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
Nr	Në nivel kombëtar	38.97	9.21	8.73	1.26	7.61	1.85
1	Belsh	37.06	9.20	8.45	1.28	7.31	1.81
2	Berat	40.76	8.34	9.00	1.14	8.01	1.78
3	Bulqizë	31.86	9.78	7.82	1.33	6.49	1.65
4	Cërrik	31.65	10.48	7.64	1.43	6.76	1.77
5	Devoll	38.41	8.48	8.70	1.18	7.23	1.89
6	Dibër	36.52	8.19	8.42	1.13	6.89	1.73
7	Divjakë	40.16	7.29	8.95	1.01	7.24	1.80
8	Durrës	40.04	8.39	8.88	1.15	7.45	1.89
9	Elbasan	36.73	10.00	8.43	1.36	7.47	1.82
10	Fier	38.97	9.01	8.74	1.23	7.54	1.88
11	Finiq-Dropull	38.02	10.24	8.61	1.44	8.09	1.63
12	Gjirokastrë-Libohovë	41.07	8.83	9.03	1.17	7.97	1.86
13	Gramsh	36.17	10.55	8.28	1.52	7.67	1.81
14	Has	37.22	7.82	8.51	1.12	7.53	1.87
15	Kamzë	39.92	7.92	8.87	1.11	7.42	1.82
16	Kavajë	39.09	10.01	8.74	1.33	7.86	1.83
17	Klos	38.80	7.03	8.68	1.05	7.52	1.64
18	Kolonje	40.84	8.83	8.97	1.19	7.94	1.79
19	Korçë-Pustec	37.65	10.20	8.54	1.37	7.58	1.85
20	Krujë	37.53	9.33	8.46	1.22	7.15	1.78
21	Kuçovë	32.19	9.56	7.80	1.32	6.96	1.79
22	Kukës	37.23	9.11	8.40	1.30	7.32	1.67
23	Kurbin	36.86	7.76	8.48	1.07	7.50	1.74
24	Lezhë	39.07	8.77	8.77	1.20	7.46	1.83
25	Librazhd	38.73	7.86	8.74	1.08	7.24	1.76
26	Lushnjë	39.39	9.32	8.82	1.26	7.75	1.89
27	Malësi e Madhe	37.71	8.81	8.57	1.22	7.33	1.82
28	Maliq	37.53	8.75	8.52	1.19	6.91	1.79
29	Mallakastër	38.55	8.25	8.68	1.14	7.46	1.70


30	Mat	35.86	9.55	8.31	1.36	7.55	1.85
31	Mirditë	36.67	9.27	8.38	1.31	7.54	1.79
32	Patos	37.09	10.18	8.47	1.43	7.36	1.81
33	Peqin	34.08	11.93	7.95	1.71	7.59	1.83
34	Përmet-Këlcyrë	38.44	9.29	8.58	1.30	7.44	1.86
35	Përrenjas	37.64	8.90	8.56	1.22	7.41	1.83
36	Pogradec	36.91	9.88	8.43	1.39	7.56	1.84
37	Poliçan	36.59	10.24	8.37	1.36	7.36	1.83
38	Pukë	36.02	10.18	8.34	1.36	7.71	1.74
39	Roskovec	36.20	9.55	8.37	1.31	7.51	1.70
40	Rrogozhinë	33.98	12.11	8.02	1.73	7.03	1.87
41	Sarandë- Konispol - Delvinë	39.66	8.44	8.86	1.15	7.70	1.87
42	Selenicë	37.20	7.17	8.51	1.05	6.91	1.68
43	Shijak	31.19	10.55	7.67	1.49	7.12	1.67
44	Shkodër	41.37	8.39	9.05	1.12	7.53	1.84
45	Skrapar	34.50	8.80	8.19	1.15	6.57	1.72
46	Tepelenë-Memaliaj	34.16	9.49	8.07	1.28	7.61	1.69
47	Tiranë	41.51	8.31	9.05	1.16	8.11	1.78
48	Tropojë	40.02	7.96	8.90	1.07	7.61	1.71
49	Dimal	30.67	11.45	7.63	1.58	7.03	1.81
50	Vau Dejës	36.64	8.50	8.45	1.15	6.98	1.79
51	Vlorë-Himarë	40.60	9.13	8.96	1.21	7.88	1.84
52	Vorë	37.45	7.25	8.51	1.01	7.11	1.81

Tabela 3.2: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive në Gjuhë të huaj.

1	2 Pikët e fituara në test			Nota e PKAB		Nota Vjetore	
	Gjinia	Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar	Vajza	41.05	8.48	9.00	1.16	8.21	1.67
	Djem	37.07	9.44	8.47	1.30	7.05	1.82
	Total	38.97	9.21	8.73	1.26	7.61	1.85
Qytet	Vajza	42.85	7.73	9.24	1.06	8.47	1.64
	Djem	39.36	8.97	8.78	1.24	7.42	1.86
	Total	41.03	8.58	9.00	1.18	7.92	1.83
Fshat	Vajza	33.68	8.83	8.65	1.21	7.83	1.65
	Djem	38.39	9.09	8.02	1.26	6.50	1.62
	Total	35.93	9.27	8.32	1.28	7.14	1.76
Publik (në nivel kombëtar)	Vajza	40.50	8.58	8.93	1.17	8.12	1.68
	Djem	36.33	9.43	8.37	1.30	6.91	1.78
	Total	38.32	9.27	8.64	1.27	7.49	1.84
Qytet	Vajza	42.23	7.97	9.16	1.09	8.36	1.67
	Djem	38.49	9.14	8.66	1.26	7.24	1.85
	Total	40.28	8.80	8.90	1.21	7.77	1.85
Fshat	Vajza	38.31	8.82	8.64	1.21	7.82	1.65
	Djem	33.58	9.07	8.00	1.26	6.48	1.61
	Total	35.85	9.26	8.31	1.28	7.12	1.76
Jopublik (në nivel kombëtar)	Vajza	46.39	4.85	9.71	0.66	9.10	1.28
	Djem	44.41	5.75	9.45	0.82	8.50	1.55
	Total	45.37	5.42	9.58	0.76	8.79	1.46
Qytet	Vajza	46.37	4.89	9.71	0.67	9.09	1.28
	Djem	44.44	5.76	9.46	0.82	8.51	1.54
	Total	45.38	5.44	9.58	0.76	8.79	1.45
Fshat	Vajza	46.90	3.75	9.74	0.56	9.26	1.17
	Djem	43.56	5.41	9.31	0.86	8.20	1.75
	Total	45.09	4.99	9.50	0.77	8.69	1.60

